

UDHËZIM
Nr. 5, datë 6.3.2012

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 18.2.2009 “PËR PËRMBAJTJEN DHE
FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pas shkronjës “m” të pikës 4 të udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe shkencës nr. 5, datë 18.2.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të shtohet shkronja “n”, si më poshtë:

“n) datën e regjistrimit të studentit në institucionin që lëshon diplomën.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Jopublik dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj